



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:177906

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06528679

2021:177907

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtarin i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehuri Sh.S. nga Shtimja, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me ND.nr.165/24, të datës 29.11.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit në njërën anë dhe përfaqësueses të autorizuar të dëmtuarës KEDC- Q. S. në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1132/2023, të datës 10.08.2021, për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 357 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, në mbështetje të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 29.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja ND.nr. 165/24, e datës 29.11.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit Sh. B. S. nga Shtimja, rruga “.....” nr. ..., i lindur me dt., me nr. personal, në njërën anë dhe përfaqësueses të autorizuar të dëmtuarës KEDC-Q. S., në anën tjetër.

Hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1132/21, e datës 10.08.2021 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurit Sh.S., për shkak të veprës penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 357 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr. 1132/21, të datës 10.08.2021, ka akuzuar të pandehurin për veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 357 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet dhe të dënohet sipas ligjit.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin fillestar me dt. 22.08.2024, konform nenit 229 të KPPRK-së dhe nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datë 29.11.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, është arritur marrëveshja ND.nr. 165/24, në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim në datën 29.11.2024, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 453 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë, e konform nenit 248 par. 1 pika 1.4 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2021:177907, datë 29.11.2024.

Zyrtare ligjore

Gjyqtari i vetëm gjykues

Kimete Bytyqi

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.